FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 109	2003	Dhjetor

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr.9155 datë 4.12.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes financiare, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor kombëtar të veprimit, "CARDS 2003""	4715
Ligj nr.9156 datë 4.12.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes financiare, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor rajonal të veprimit, "CARDS 2003""	4730
Vendim i KM nr.851, datë 19.12.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimi i depos së ujit të ujësjellësit të Poloskës në Qendër, Devoll të qarkut të Korçës	4747
Vendim i KM nr.853, datë 19.12.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.309, datë 15.5.2003 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e punonjësve të administratës së Albkrom sh.a., që shkurtohen nga privatizimi dhe dhënia me koncesion e industrisë së kromit"	4748
Vendim i KM nr.854, datë 19.12.2003	Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit...	4748

Vendim i KM nr.855, datë 19.12.2003	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.588, datë 22.12.1997 të Këshillit të Ministrave "Për procedurën zyrtare të caktimit të delegacionit shqiptar në Kongresin Europian të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale".....	4750
Vendim i KM nr.856, datë 4.12.2003	Për një shtesë në vendimin nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e misionit të Republikës së Shqipërisë pranë selisë së NATO-s".....	4751
Vendim i ERE nr.22, datë 30.12.2003	Për çmimet dhe tarifat e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2004.....	4751
	Ndreqje gabimi.....	4753

L I G J
Nr.9155, datë 4.12.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE, PËR PROGRAMIN VJETOR KOMBËTAR TË VEPRIMIT, "CARDS 2003""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor kombëtar të veprimit, "CARDS 2003"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4073, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIARE
KUSHTET SPECIALE

Komuniteti Europian, këtu e tutje referuar si "Komuniteti", i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtu e tutje referuar si "Komisioni",

nga njëra anë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, këtu e tutje referuar si "Përfituesi", nga ana tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Natyra dhe qëllimi i veprimit

1.1 Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit "Programi vjetor i veprimit 2003 për Shqipërinë", këtu e tutje referuar si "programi", i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

1.2 Ky program do të zbatohet në përputhje me Marrëveshjen financiare dhe shtojcat e saj: kushtet e përgjithshme (shtojca I) dhe dispozitat teknike dhe administrative (shtojca II).

Qeveria nuk do të ndryshojë destinacionin dhe përdorimin fillestar dhe/ose të synuar të pajisjeve të dërguara, ambienteve dhe godinave të restauruara pjesërisht dhe/ose plotësisht me fondet e Komunitetit, përveç rastit kur bihet dakord ndryshe me Komisionin.

Neni 2
Kontributi i financuar i Komunitetit

2.1 Kostoja totale e programit është 46 500 000 euro.

2.2 Komuniteti merr përsipër financimin e 46 500 000 euro. Ndarja e kontributit financiar të Komunitetit, sipas zërave të buxhetit, është përshkruar në buxhetin e përfshirë në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

Neni 3

Kontributi i Përfituesit

Aty ku pjesë e, apo i gjithë kontributi i Përfituesit është i një natyre jofinanciare, rregullat e detajuara do të përcaktohen në një memorandum mirëkuptimi të veçantë në lidhje me çdo program/projekt.

Neni 4

Periudha e ekzekutimit

Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë, e shumta, në datë 31.12.2009. Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative të zbatimit, e cila do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datë 31.12.2007. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së ekzekutimit.

Neni 5

Afati për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të nënshkruhen, e shumta, brenda datës 16.7.2006. Ky afat nuk mund të shtyhet.

Neni 6

Adresat

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes financiare do të jenë të shkruara, do t'i referohen shprehimisht programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) Për Komisionin
Komisioni i Komuniteteve Europiane
Zyra Europiane e Ndihmës dhe e Bashkëpunimit
(L41 4/2)
Z.Per Brix Knudsen
Drejtor
B-1049 Bruksel, Belgjikë
Fax: +32 2 295 74 82

b) Për Përfituesin
Znj. Ermelinda Meksi
Ministër Shteti për Integrimin Europian
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4 25 62 67

Neni 7

Shtojcat

7.1 Dokumentet e mëposhtme do t'i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje dhe do të përbëjnë pjesë integrale të saj:

Shtojca I:Kushtet e përgjithshme

Shtojca II:Dispozitat teknike dhe administrative

7.2 Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe atyre të kushteve speciale të Marrëveshjes financiare, dispozitat e kushteve speciale do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe atyre të shtojcës II, dispozitat e shtojcës I do të kenë përparësi.

Neni 8

Kushte të tjera speciale të zbatueshme për programin

8.1 Kushtet e përgjithshme plotësohen nga dispozitat e mëposhtme:

8.1.1 Programi do të zbatohet nga shërbimet e Komisionit në emër dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kombëtare dhe/ose lokale të interesuara.

8.1.2 Zbatimi i decentralizuar nga autoritetet shqiptare mund të konsiderohet për një nga projektet e programit; programi i zhvillimit të komuniteteve lokale (7 500 000 euro). Vendimi për decentralizimin e zbatimit do të merret me anë të një shkëmbimi letrash midis Komisionit dhe Përfituesit.

Neni 9

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

Marrëveshja financiare do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo do të nënshkruhet nga pala e fundit.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për Përfituesin.

Për Komisionin
Z.Per Brix Knudsen
Drejtor
Zyra Europiane e Ndihmës dhe e Bashkëpunimit
Bruksel
data

Për Përfituesin
Znj. Ermelinda Meksi
Ministër Shteti për Integrimin Europian
Tiranë

Rezervë: Përsa i përket nenit 9, kjo Marrëveshje financiare do të hyjë në fuqi për palën shqiptare në datën e ratifikimit të saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR SHTETI
PËR BASHKËPUNIMIN EUROPIAN
Ermelinda Meksi

SHTOJCA I

KUSHTET

TITULLI I
FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

Neni 1

Parime të përgjithshme

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do të kushtëzohet nga plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje financiare nga ana e Përfituesit.

Neni 2
Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre

2.1 Tejkalimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale, të përcaktuar në Marrëveshjen financiare, Komisioni mund ose të zvogëlojë projektin/programin, ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfituesit ose burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se projekti/programi nuk mund të zvogëlohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet as nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë, në mënyrë të jashtëzakonshme, financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

TITULLI II
ZBATIMI

Neni 3
Kushte të përgjithshme

3.1 Projekti/programi do të zbatohet nga Komisioni, duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e Përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4
Periudha e ekzekutimit

4.1 Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë, e shumta, në datë 31.12.2009. Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative zbatimi, e cila do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datë 31.12.2007. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së ekzekutimit.

Gjatë fazës së mbylljes do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllen teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë, e shumta, 24 muaj pas kësaj date.

4.2 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financimin e Komunitetit vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.3 Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të fshihet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit.

4.4 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara

përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

TITULLI III
LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANTEVE

Neni 5
Kushte të përgjithshme

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme në fuqi, në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

Neni 6
Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të nënshkruhen nga të dyja palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, pra deri në datë 16.7.2006. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Norma e mësipërme nuk do të aplikohet për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 6.1 të këtyre kushteve, çdo fond, për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë nuk janë nënshkruar, do të fshihet.

6.4 Çdo kontratë për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të fshihen.

Neni 7
Pranueshmëria

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tendera për kontratat për punime, furnizime ose shërbime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë, të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në konkurset për propozime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3. Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që, në bazën e kushteve specifike të përcaktuara në aktet bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2, të marrin pjesë në tenderat për kontratat.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komuniteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit, të nisura nga përfituesi i grantit për ekzekutimin e aktivitetit të financuar, duhet ta kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për të marrë pjesë, siç përcaktohet në tre paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të aplikohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët do të marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

TITULLI 4
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

Neni 8
E drejta e vendosjes dhe e qëndrimit

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë, që marrin pjesë në ftesat për tendera për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve, do të gëzojnë të drejtën e përkohshme të vendosjes dhe të qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës.

8.2 Kontraktorët (duke përfshirë përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të projektit/programit.

Neni 9
Norma tatimore dhe doganore

9.1 Tatimet, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksa ekuivalente) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues duhet të aplikojë për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të aplikuara për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ai ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 10
Normat mbi kursin e këmbimit

10.1 Shteti përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të aplikojë normativën e tij kombëtare për këmbimin e valutës në një mënyrë jodiskriminuese për kontraktorët që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 11
Përdorimi i të dhënave nga studimet

Aty ku Marrëveshja financiare përfshin financimin e një studimi, kontrata në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes financiare, duhet të rregullojë pronësinë e këtij studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit ose të Komisionit për të përdorur të dhënat në studim, për ta publikuar atë ose për t'ua dhënë palëve të treta.

Neni 12
Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht, nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara, në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, duhet të alokohen për projektin/programin.

12.2 Ndëshkimet financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati ose pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit do t'i ripaguhen buxhetit të përgjithshëm të komuniteteve europiane.

TITULLI 5
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Transparenca

13.1 Çdo projekt/program i financuar nga komuniteti do të jetë objekt i operacioneve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme, në fuqi, në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

Neni 14
Parandalimi i parregullsive, mashtrimit dhe korrupsionit

14.1 Përfituesi duhet të marrë masat e përshtatshme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet dhe, me kërkesë të Komisionit, të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 "Parregullsi" do të thotë çdo shkelje e Marrëveshjes financiare, kontratave të zbatimit ose të të drejtës komunitare, e cila shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik, dhe që ka ose do të kishte si efekt cenimin e buxhetit të përgjithshëm të komuniteteve europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura direkt në emër të komuniteteve europiane, ose nga çdo zë i pajustifikuar shpenzimi.

"Mashtrimi" do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm që lidhet me:

- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve ose deklaratave të rreme, jokorrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i komuniteteve evropiane ose nga buxhetet e administruara prej tyre ose në emër të tyre;
- mosdhënien e informacionit në kundërshtim me detyrimet specifike, me të njëjtin efekt;
- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për dhënien e kontratave ose granteve ose në zbatimin e kontratave që lidhen me të. "Korrupsion pasiv" do të thotë veprim i paramenduar i një nëpunësi, i cili, direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji, çfarëdo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të komuniteteve europiane. "Korrupsion aktiv" do të thotë veprim i paramenduar i cilitdo që, direkt apo nëpërmjet një ndërmjetësi, i premton ose i jep një avantazh të çdo lloji, çfarëdo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të komuniteteve europiane.

Neni 15
Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra Europiane Antimashtrim (OLAF) dhe Gjykata e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni apo në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes financiare (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave dhe granteve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse është e domosdoshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël, si dhe të çdo dokumenti

tjetër që lidhet me financimin e projektit/programit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiare të komuniteteve europiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t'u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF dhe të Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes financiare janë kryer, duke përfshirë sistemet e tyre kompjuterike, si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar, që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Europian, të OLAF dhe Gjykatës së Kontrollit Financiar të komuniteteve europiane do të jepet në kushtet e një konfidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilës ato i nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në një mënyrë që të lejojë inspektim të lehtë të tyre. Përfituesi është i detyruar të njoftojnë Komisionin, OLAF ose Gjykatën e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrollet dhe kontrollet financiare të përmendura më sipër do të aplikohen edhe për kontraktorët dhe nënkontraktorët, të cilët kanë përfituar financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni, OLAF ose Gjykata e Kontrollit Financiar.

Neni 16
Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit

16.1 Përfituesi dhe Komisioni do të konsultojnë njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje, në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në ndryshimin, ndërprerjen ose përfundimin e Marrëveshjes financiare.

Neni 17
Ndryshimet në Marrëveshjen financiare

17.1 Çdo ndryshim për shtojcën II të Marrëveshjes financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për një ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit duhet t'ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuara nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit ose fazës së mbylljes janë të rregulluara nga neni 4(5) dhe (6) i këtyre kushteve.

Neni 18
Pezullimi i Marrëveshjes financiare

18.1 Marrëveshja financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes financiare, në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja financiare.

b) Komisioni mund të pezullojë Marrëveshjen financiare, në qoftë se Përfituesi shkel një detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në rastet serioze të korrupsionit.

c) Marrëveshja financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi dhe që nuk mund t'i ngarkohet një gabimi ose pakujdesie të tyre (ose kontraktorëve të tyre, përfaqësuesve ose

punonjësve), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen. Difektet në pajisje ose materiale ose vonesat për t'i bërë të disponueshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose në vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Një palë nuk do të konsiderohet shkelje të detyrimeve të saj në qoftë se nuk ka mundur t'i përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore duhet të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problemit. Gjithashtu, ajo duhet të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 19

Përfundimi i Marrëveshjes financiare

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes financiare nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo palë mund të mbarojë Marrëveshjen financiare me dy muaj paralajmërim.

19.2 Kur një marrëveshje financiare nuk ka filluar ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë firmosur, sipas datave të përcaktuara në nenin 6.1 të këtyre kushteve, atëherë Marrëveshja financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 20

Rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anën e arbitratit me kërkesën e njërës prej palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga palët do të caktojë një arbitër brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës për arbitër. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, do të caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditësh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit të caktojë arbitrin e tretë.

20.3 Përveç rastit kur arbitrat vendosin ndryshe, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në rregullat fakultative të arbitrimit për organizatat ndërkombëtare dhe shtetet të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit. Vendimi i arbitrave do të merret me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për aplikimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA II

MASAT TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE

1. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Objektivi i përgjithshëm i ndihmës së BE-së përcaktohet në kuadrin e procesit të stabilizim-asocimit (PSA) dhe përfshin forcimin e shtetit të së drejtës dhe stabilizimin demokratik, si dhe zhvillimin ekonomik dhe social.

Objektivat e veçanta të programit janë:

- Drejtësia dhe punët e brendshme: kontribut për forcimin e shtetit të së drejtës, stabilitetin demokratik dhe zhvillimin ekonomik, duke u përqëndruar në forcimin e kapaciteteve institucionale, trajnimet dhe investimet mbështetëse.

- Forcimi i kapaciteteve administrative: përmirësimi i funksionimit të strukturave shtetërore dhe mbështetja për krijimin e një ekonomie tregu demokratike funksionale.

- Zhvillimi ekonomik dhe social: nxitja e zgjerimit të sektorit privat dhe krijimi i vendeve të punës, në kuadrin e procesit të stabilizim-asocimit, për të nxitur zhvillimin e komunitetit lokal dhe përmirësimin e arsimit të mesëm, të lartë dhe trajnimet, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.

- Stabilizimi demokratik: fuqizimi i pjesëmarrjes së shoqërisë në zgjedhje.

2. DETAJET E PROGRAMIT

2.1 Drejtësia dhe punët e brendshme (DPB)

Aktivitetet e financuara në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme bazohen në përfundimet e misionit të vlerësimit 2002 për DPB-në të ekspertëve të Komisionit Europian dhe shteteve anëtare.

Rinovimi i dy gjykatave të apelit (Korçë dhe Vlorë)

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për përmirësimin e ndjekjes penale në dhe përmirësimin e administrimit të sistemit të drejtësisë, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për shqyrtimet e çështjeve në apel, nëpërmjet:

- rinovimit të dy gjykatave të apelit (Korçë dhe Vlorë);
- supervizionit të punimeve të rinovimit;
- në qoftë se mbeten fonde, sigurimit të mobiljeve dhe pajisjeve.

Projekti do të realizohet nëpërmjet kontratave për punime dhe kontratave për shërbime supervizioni. Punimet që lidhen në vizatimin e projektit të ndërtimit do të financohen nga programi i veprimit 2002.

Trajnimi dhe pajisje për administratën e gjykatave

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për një administrim më të mirë të çështjeve të gjykuara, nëpërmjet:

- ofrimit të trajnimit për administratën e gjykatave;
- sigurimit të një programi trajnimi të përhershëm për administratën e gjykatave;
- trajnimin e trajnerërve që do të realizojnë këto programe;
- sigurimin e pajisjeve administrative për administratën e gjykatave.

Projekti do të realizohet nëpërmjet asistencës teknike, trajnimit dhe kontratave për furnizime.

Ndërtimi dhe krijimi i Gjykatës për Krimet e Rënda

Në bazë të rekomandimeve të misionit të vlerësimit për DPB-në të vitit 2002, objektivi i përgjithshëm është përmirësimi i mundësive që çështjet për krime të rënda të shqyrtohen në sistemin shqiptar të drejtësisë, nëpërmjet:

- ndërtimit të pajisjes së Gjykatës për Krimet e Rënda;
- supervizionit të punimeve të ndërtimit;
- në qoftë se mbeten fonde, sigurimit të mobiljeve për gjykatën.

Projekti do të realizohet nëpërmjet kontratave për punime dhe kontratave për shërbime supervizioni. Punimet që lidhen me vizatimin e projektit të ndërtimit do të financohen nga plani i veprimit 2002.

Task-forcë kundër krimeve të rënda

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet:

- krijimit të një qendre të analizës të të dhënave të shërbimeve informative dhe të task-force për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave;
- trajnimit të personelit;
- blerjes së pajisjeve të nevojshme (hardware and software), si dhe kryerjes së disa punimeve për zyrat ku do të sistemohet qendra dhe task-forca.

Projekti është hartuar si një komponent plotësues për aktivitetet e misionit të BE-së për policinë (PAMECA).

Administrimi i bazës materiale të policisë

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në përmirësimin e mirëmbajtjes nga Shqipëria të pajisjeve të dhuruara nga programet e kaluara, të tashme dhe të ardhme, nëpërmjet:

- krijimit të një kulture për administrimin e bazës materiale në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Furinizimit në Ministrinë e Rendit Publik;

- krijimit të një plani administrimi të bazës materiale;
- përmirësimit të kufizuar të disa zyrave të Drejtorisë së Shërbimeve dhe Furnizimeve, të disa depove të furnizimit dhe ofiçinave, me qëllim pajisjen e tyre me hardware dhe software, të nevojshëm për administrimin e bazës materiale;
- sigurimi të hardwar-ve dhe softwar-ve të nevojshëm;
- trajnimit të personelit të interesuar për programet kompjuterike dhe planet e administrimit të bazës materiale;

Përmirësimi i administrimit të kufirit tokësor, pikave të kalimit të kufirit dhe postave të Policisë Kufitare

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në luftën kundër krimit të organizuar, duke administruar më mirë kufirin tokësor dhe pikat e kalimit të kufirit, nëpërmjet:
- përgatitjes së udhëzuesve mbi administrimin e kufijve për personelin kufitar;
- përmirësimit të disa pikave të kalimit të kufirit;
- shënimit në mënyrë të përshtatshme të kufijve në liqenin e Shkodrës, Ohrit dhe Prespës;
- trajnimit të personelit kufitar;
- sigurimit të pajisjeve.

Projekti do të realizohet nëpërmjet një kontrate për furnizime dhe një kontrate për shërbime.

Supervizioni i punimeve në portin e Durrësit

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në zhvillimin e portit kryesor të Shqipërisë, Durrësit, i cili ndodhet në fundin e Korridorit VIII pan-europian dhe që mund të ndihmonte integrimin rajonal, nëpërmjet:
- ofrimit të ekspertizës për të përfunduar dosjen e punimeve për zonën e magazinimit të kontinerëve në portin e Durrësit;
- supervizionit të punimeve të ndërtimit për shtrimin e rrugës dhe drenazhin e zonës së magazinimit të kontenierëve sipas kontratave për punime.

Kontratat për punime do të financohen nga Banka Europiane e Investimeve. Ky projekt ka lidhje vetëm me supervizionin e punimeve.

Kontrolli paraprak i azilkërkuesve dhe migrantëve

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për zhvillimin e një politike migrimi duke konsoliduar procedurat ekzistuese të kontrollit paraprak të kufijve për kategorizimin në azilkërkues, viktima të trafikut dhe emigrantë, nëpërmjet:
- përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet organeve dhe ministrive kompetente për këtë fushë;
- krijimit të një sistemi të monitorimit të lëvizjeve migratore;
- përgatitjes së materialeve të trajnimit dhe materialeve informuese;
- trajnimit të Policisë Kufitare dhe të Shtetit, si dhe mbështetjes së personelit që ka të bëjë me emigrantët dhe azilkërkuesit;
- rehabilitimit të tetë strehimeve të përkohshme për emigrantët dhe azilkërkuesit në kufi;
- funksionimit të plotë të qendrave të pritjes në Babru dhe Linzë.

Suksesi i projektit do të varet nga bashkëpunimi i disa institucioneve shtetërore dhe donatorëve ndërkombëtarë në këtë fushë. Përpara fillimit të zbatimit të projektit, Komisioni do të kërkojë nënshkrimin e një memorandumi mirëkuptimi midis këtyre palëve.

2.2 Forcimi i kapaciteteve administrative

Mbështetja për doganat

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për aftësitë e administratës shqiptare në vjeljen e të ardhurave dhe përmirësimin e prodhimit të të ardhurave shtetërore në fushën e doganave, nëpërmjet:
- sigurimit të vazhdueshëm të konsulencës mbi legjislacionin, procedurat, pajtimin me to dhe imponimin e tyre;
- administrimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë konsulencën mbi marrjen në punë, trajnimin, zhvillimin e karrierës, pagat dhe kategorizimin në shërbimin doganor shqiptar;
- kompjuterizimit të shërbimit nëpërmjet sistemit ASYCUDA;
- përqëndrimit të qartë në luftën kundër trafiqeve të paligjshme (të drogës, armëve, pastrimit të parave), nëpërmjet përmirësimit të grumbullimit të informatave dhe punës hetimore.

Projekti do të zbatohet nëpërmjet misionit të BE-së në Shqipëri për mbështetjen e doganave (CAM-A), krijuar në vitin 1997 në bashkëpunim të ngushtë me misionin e BE-së në Shqipëri për mbështetjen e policisë.

Mbështetje për tatimet

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në aftësinë e administratës shqiptare për vjeljen e të ardhurave dhe përmirësimin e prodhimit të të ardhurave shtetërore në fushën e tatimeve, nëpërmjet:

- sigurimit të vazhdueshëm të konsulencës mbi legjislacionin, procedurat, pajtimin me to dhe imponimin e tyre në fushën e tatimeve, duke përfshirë vjeljen e kontributeve sociale;
- rishikimit të taksës së rendit dhe mbrojtjes dhe mbështetjes për zbatimin e ndryshimeve për të cilat është rënë dakord;
- sigurimit të pajisjeve dhe mbështetjes për projektin e kompjuterizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në Ministrinë e Financave, si pjesë e mbështetjes ekzistuese të FMN-së dhe Qeverisë Britanike.

Projekti do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me administratën doganore shqiptare.

Reforma në administratën publike

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në përmirësimin e kapaciteteve administrative të Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet:

- sigurimit të konsulencës për Departamentin e Administratës Publike;
- rritjes së vetëdijes mbi ligjin e shërbimit civil, përfshirë ligjin e ri mbi etikën dhe nëpërmjet fushatës kundër korrupsionit;
- trajnimit të nëpunësve civilë dhe trajnimit të trajnerëve.

Projekti do të bazohet gjerësisht në projektet e kaluara të financuara nga BE-ja mbi zhvillimin e administratës publike në Shqipëri.

2.3 Zhvillimi ekonomik dhe social

Mbështetje për standardet, certifikimin dhe akreditimin

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare për mallrat shqiptare, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe mbrojtjen e konsumatorit, nëpërmjet:

- përshtatjes së praktikave shqiptare në fushën e standardeve, testimit të certifikimit e inspektimit dhe akreditimit me rregulloret e BE-së;
- bërjes funksionale të organizmit të ri të akreditimit;
- përmirësimit të institucioneve të përfshira në procesin e vlerësimit të konformitetit, duke përfshirë laboratorët;
- rritjes së vetëdijes mbi standardet dhe certifikimin, duke përfshirë edhe prodhuesit shqiptarë.

Projekti bazohet në projektin e standardeve dhe certifikimit të programit CARDS 2001, i cili përqëndrohet më shumë në mbështetjen për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit. Projekti lidhet ngushtësisht me projektet e metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut të përfshira në këtë program.

Metrologjia

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për rritjen e mundësive të eksportit për produktet shqiptare me një cilësi më të mirë të prodhimit, nëpërmjet:

- vlerësimit të nevojave për metrologjinë, duke zhvilluar në strategji dhe duke e zbatuar atë për fushat e zgjedhura si prioritare;
- ndihmesës në adaptimin e udhëzuesve, modeleve të rregullave ndërkombëtare dhe kërkesave teknike të BE-së;
- përmirësimit të kapaciteteve administruese të Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DKMK);
- zhvillimit të një programi trajnimi për DKMK-në;
- rritjes së vetëdijes së publikut mbi metrologjinë.

Projekti është bazuar në aktivitetet e mëparshme të BE-së në këtë fushë. Projekti ka lidhje të ngushtë me projektet e standardeve dhe mbikëqyrjes së tregut, përfshirë në këtë program dhe në programet dypalëshe me DKMK-në.

Projekti do të kontraktohet direkt me qendrën e përbashkët të kërkimeve, Institutin e

Materialeve të Referencës dhe Matjeve (IMRM), i cili është një organizëm europian i krijuar për të nxitur një sistem të përbashkët europian të matjeve, në mbështetje të politikave të BE-së, veçanërisht të atyre për mbrojtjen e shëndetit dhe konsumatorit, ambientin, bujqësinë, tregun e brendshëm dhe standardet industriale.

Sistemi i mbikëqyrjes së tregut

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për mbrojtjen e konsumatorit dhe për nxitjen e tregtisë së lirë nëpërmjet:

- krijimit të një sistemi të mbikëqyrjes së tregut për Shqipërinë;
- trajnimit të nëpunësve civilë të institucioneve shtetërore kompetente për çështjet e konsumatorit dhe personelit të Shoqatës për mbrojtjen e konsumatorit mbi mbikëqyrjen e tregut dhe shkëmbimin e informacionit;
- përgatitjes së Shqipërisë për të marrë pjesë në të ardhmen në sistemin e shpejtë të alarmit për shkëmbimin e informacionit të BE-së;
- rritjes së vetëdijes mbi çështjet e konsumatorit.

Projekti lidhet ngushtë me projektin e standardeve dhe certifikimit dhe projektin e metrologjisë. Ai lidhet pjesërisht me projektet e tregtisë të programit CARDS 2002.

Monitorimi i shëndetit të kafshëve të imta

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për zhvillimin e një tregu eksporti për kafshët e imta, duke ndjekur më mirë sëmundjet e kafshëve, nëpërmjet:

- krijimit të një sistemi të regjistrimit të kafshëve (nëpërmjet vendosjes së numrit në vesh), kryesisht në pjesën jugore të Shqipërisë;
- trajnimit të personelit që do të punojë me këtë sistem, duke u përqëndruar në përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme tek kafshët e tjera ose te njerëzit;
- trajnimit të personelit dhe sigurimit të pajisjeve për Institutin Kombëtar Epidemiologjik dhe Institutin e Veterinarisë.

Prodhimi dhe monitorimi i molusqeve

Objekti i përgjithshëm është kontributi për zhvillimin e një tregu eksporti për molusqet, duke monitoruar më mirë ujërat bregdetare, nëpërmjet:

- ngritjes së sistemit të monitorimit të ujërave bregdetare për molusqet në tetë zona kryesore të monitorimit (kryesisht Butrint dhe Sarandë), duke u bazuar në standardet e BE-së;
- mbledhjes së të dhënave mbi gjendjen e ndotjes, pranisë së toksinës dhe mbeturinave;
- krijimit të një qendre të mbledhjes së butakëve, ndoshta në Sarandë.

Fuqizimi i kontrollit veterinar/fito-sanitar

Objektivi i përgjithshëm është kontributi për zhvillimin ekonomik, duke pakësuar rënien e prodhimit dhe humbjen e kafshëve në Shqipëri të shkaktuara nga importet, si dhe mbrojtjen e shëndetit njerëzor, duke kontrolluar sigurinë e ushqimeve, nëpërmjet:

- konsulencës mbi një sistem kontrolli në kufi që duhet të krijohet, duke përfshirë sistemin e komunikimit të nevojshëm dhe strukturat raportuese;
- pajisjes së laboratorëve diagnostikues rajonalë, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të kryejnë kontrolle të shpejta verifikuese;
- pajisjes së dhjetë postave kufitare me pajisjet bazë të kontrollit (termometër, mikroskopë, etj.);
- trajnimit të kontrollorëve në kufi për të kryer kontrollet mbi importet dhe eksportet, në përputhje me kriteret ndërkombëtare.

Programi i zhvillimit të komuniteteve lokale

Objektivi i përgjthshëm është përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale të Shqipërisë dhe zhvillimi i vetëdijes së komuniteteve të këtyre zonave, nëpërmjet:

- ndërtimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës lokale;
- përfshirjes së komuniteteve lokale në procesin e vendimmarrjes mbi këto projekte.

Programi i zhvillimit të komuniteteve lokale mund të zbatohet në mënyrë të decentralizuar. Në

këtë rast, Komisioni do të nënshkruajë një memorandum mirëkuptimi me Shqipërinë, i cili do të mbulojë modalitetet e zbatimit.

Tempus

Objektivi i përgjithshëm është nxitja e reformës në institutet e arsimit të lartë në Shqipëri, në kuadrin e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies akademike dhe mësimit, në përputhje me ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike, nëpërmjet:

- mbështetjes së politikave të arsimit të lartë;
- fuqizimit të lidhjeve me ekonominë lokale dhe rajonale;
- zhvillimit të programeve mësimore në fushat prioritare për tranzicionin ekonomik dhe social;
- kontributit për lëvizshmërinë e studentëve dhe personelit;
- fuqizimit të bashkëpunimit rajonal.

Mbështetje për arsimin profesional dhe reformën e trajnimit

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në zhvillimin e arsimit profesional dhe sistemit të trajnimit (APT) që do të ndihmojë në stabilitetin ekonomik dhe social të Shqipërisë, duke siguruar një forcë pune të kualifikuar, nëpërmjet:

- krijimit të kapaciteteve institucionale në nivel kombëtar dhe rajonal për të përforcuar reformën sistematike të APT-së; kjo përfshin krijimin e një agjencie kombëtare profesionale;
- krijimit të një sistemi të ri standardesh punësimi, informacioni mbi tregun e punës, vlerësimi të programeve mësimore etj.;
- drejtimit, zbatimit dhe vlerësimit të sistemit të ri APT dhe decentralizimit të ofrimit të APT-së, në përputhje me strategjinë kombëtare.

Projekti do të jetë i koordinuar ngushtë me projektin APT të programit CARDS 2002.

2.4 Stabilizimi demokratik

Rifreskimi i regjistrit të gjendjes civile

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në praktikimin e demokracisë në Shqipëri, duke ofruar një mjet bazë për mbajtjen e zgjedhjeve, nëpërmjet:

- krijimit të një regjistri qendror të kompjuterizuar të gjendjes civile, në bazë të të cilit të sigurohet lista e saktë e zgjedhësve;
- sigurimit të pajisjeve;
- trajnimit të stafit të një njësie të hedhjes së të dhënave në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit;
- hedhjes së të dhënave të regjistrit të gjendjes civile në një kompjutër qendror.

Projekti do të sigurojë lista të pakontestueshme të votuesve për zgjedhjet e ardhshme. Projekti do të zbatohet nëpërmjet një kontrate për shërbime dhe një kontrate për furnizime.

3. KOSTOT DHE FINANCIMI

Programi do të financohet nëpërmjet një granti të komunitetit prej 46 500 000 euro, i ndarë si më poshtë vijon midis fushave të ndryshme:

Fusha/Projekti	Totali për fushën euro milion
1. Drejtësia dhe punët e brendshme	20,00
1.1 Reforma në drejtësi	5,00
1.2 Policia dhe krimi i organizuar	8,00
1.3 Administrimi i integruar i kufijve	5,00
1.4 Azili dhe migrimi	2,00
2. Forcimi i kapaciteteve administrative	8,00
2.1 Doganat	4,00
2.2 Tatimet	3,00
2.3 Reforma në administratën publike	1,00
3. Zhvillimi social dhe ekonomik	17.50
3.1 Tregtia	7.50
3.2 Zhvillimi i komuniteteve lokale	7.50

3.3 Arsimi	2.50
4. Stabilizimi demokratik	1.00
4.1 Stabilizimi demokratik	1.00
Totali	46.50

4. RREGULLAT E ZBATIMIT

4.1 Zbatimi dhe administrimi

Marrëveshja financiare duhet të lidhet brenda 31 dhjetorit të vitit në vijim të vitit të çeljes së fondeve.

Përfundimi i periudhës së zbatimit të Marrëveshjes financiare është përcaktuar këtu më 31.12.2007.

Çdo shumë fondesh e mbetur në dispozicion nën grantin e Komunitetit Europian do të anulohet automatikisht 18 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit të Marrëveshjes financiare.

Kontratat e financuara nga ky program do të hyjnë në fuqi jo më shpejt sesa firmosja e Marrëveshjes financiare në formën e duhur nga firmëtarët kompetentë dhe jo më vonë se 3 vjet duke nisur nga data e çeljes së fondeve. Për këtë:

- çdo kontratë ose grant duhet të ketë hyrë në fuqi pasi të jetë nënshkruar nga të gjitha palët e interesuara, përpara kësaj date të skadimit të afatit;
- çdo kontratë ose grant që nuk ka hyrë në fuqi, duke qenë e nënshkruar nga të gjitha palët e interesuara përpara datës së skadimit të afatit do të anulohet *ex-tunc*;
- çdo shumë fondesh e këtij programi që nuk përdoret për të financuar kontrata ose grante që janë në fuqi në datën e skadimit të afatit do të mbyllet sa më shpejt që të jetë e mundur pas kësaj date;
- asnjë shtesë që shton fonde prej këtij programi për çfarëdo kontratë ose grant nuk mund të hyjë në fuqi pas kësaj date të skadimit të afatit.

Ky program do të zbatohet nga Komisioni, në emër të dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e interesuara kombëtare dhe/ose lokale. Zbatimi i decentralizuar mund të konsiderohet për rastin e programit të zhvillimit të komunitetit lokal. Shërbimet përkatëse të Komisionit do të marrin përsipër zbatimin e projektit. Një marrëveshje financiare korresponduese me propozimin financiar do të lidhet me autoritetet partnere.

4.2 Tenderimi dhe lidhja e kontratave

Kontratat për shërbime, punime dhe furnizime duhen të lidhen në përputhje me rregullat e tenderimit dhe të lidhjes së kontratave të përcaktuara në rregulloren financiare dhe udhëzime të tjera.

4.3 Monitorimi, vlerësimi dhe kontrolli financiar

Ky program do të monitorohet dhe kontrollohet nga shërbimet e Komisionit Europian, të cilat:

- do të monitorojnë zbatimin e programit në bazë të raporteve të rregullta, kontakteve me të gjithë të interesuarit dhe vizitave në vend;
- do të realizojnë monitorime dhe vlerësime të rregullta për ndjekjen e progresit të programit dhe të komponentëve të tij, si dhe vlerësimet pas përfundimit të programit.

Llogaritë dhe veprimet e kryera nën komponentët e programit do të kontrollohen me intervale nga një kontrollues financiar i jashtëm, i kontraktuar nga Komisioni, pa përjashtuar përgjegjësitë e Komisionit Europian, duke përfshirë Zyrën Europiane Antimashtrim (OLAF) dhe Gjykatën e Kontrollit Financiar të Bashkimit Europian.

5. ANGAZHIMET E QEVERISË /KUSHTËZIMET

Ndihma ofrohet mbi bazën e ekzistencës së elementeve të nevojshme për vazhdimin e bashkëpunimit nëpërmjet ndihmës, në veçanti respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave të njeriut.

L I G J
Nr.9156, datë 4.12.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE, PËR PROGRAMIN VJETOR RAJONAL TË VEPRIMIT, "CARDS 2003""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor rajonal të veprimit, "CARDS 2003"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4074, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Bruksel,
AIDCO/A1/YSJ/D(2003) 298
92

Zj. Ermelinda Meksi
Zv/ Kryeministër
dhe Ministër Shteti për
Integrimin Europian
Republika e Shqipërisë

Lënda

Letër për përfitimin nga programi vjetor i veprimit CARDS 2003

E nderuar zonjë,

Kam kënaqësi t'ju dërgoj programin vjetor rajonal të veprimit CARDS 2003 për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Serbinë e Malin e Zi (Republika e Serbisë, Kosova*, Republika e Malit të Zi) dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), siç është miratuar nga Komisioni Europian në 16 korrik 2003 sipas Rregullores së Këshillit për Programin CARDS (EC) nr.2666/2000, ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit (EC) nr.2415/2001 datë 10 dhjetor 2001.

*nën administrimin ndërkombëtar sipas RKSKB. 1244 të datës 10 qershor 1999

Programi vjetor rajonal i veprimit CARDS 2003 financohet nga Komisioni Europian si grant me një buxhet prej 31 500 000 euro.

Programi vjetor rajonal i veprimit CARDS 2003 reflekton Dokumentin Strategjik Rajonal (DSR), të miratuar për vitet 2002-2006 dhe Programin Indikativ Shumëvjeçar (PISH) trevjeçar për periudhën 2002-2004.

Katër fusha prioritare janë identifikuar në programin vjetor rajonal të veprimit CARDS 2003, duke u bazuar në Dokumentin Strategjik Rajonal (D.S.R), të miratuar për vitet 2002-2006 dhe në Programin Indikativ Shumëvjeçar (P.I.SH.) trevjeçar për periudhën 2002-2004. Programi konsiston në projekte në fushat prioritare të mëposhtme:

- nxitja e administrimit të integruar të kufijve;
- forcimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore;
- mbështetje për stabilizimin demokratik;
- forcimi i infrastrukturës rajonale dhe i zhvillimit ambiental.

Programi do të zbatohet dhe administrohet nga Zyra Europiane e Ndihmës dhe Bashkëpunimit, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Marrëdhënieve të Jashtme. Kjo Marrëveshje financiare duhet të nënshkruhet nga të dyja palët përpara datës 31 dhjetor 2004. Dokumentet e mëposhtme do t'i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje financiare dhe do të jenë pjesë përbërëse e saj:

Shtojca 1: Kushtet e përgjithshme

Shtojca 2: Kushtet teknike dhe administrative

Të gjitha kontratat e financuara nga ky propozim financiar duhet të firmosen brenda datës 16 korrik 2006. Vendet mund të përfitojnë nga projektet e financuara nga ky program, vetëm në qoftë se kundërfirmosin Marrëveshjen financiare.

Do të isha mirënjohës nëse Ju do të vërtetonit marrjen e kësaj letre, duke nënshkruar dy origjinalet dhe duke dërguar një prej tyre te ne.

Sinqerisht i Juaji,

Z. Per Brix Knundsen
Drejtor i Zyrës Europiane të Ndihmës dhe Bashkëpunimit
Bruksel

Znj. Ermelinda Meksi
Zv/Kryeministri dhe Ministri i Shtetit për Integrimin Europian
Republika e Shqipërisë
Tiranë

Rezervë: Programi vjetor rajonal i veprimit CARDS 2003 do të hyjë në fuqi për palën shqiptare në datën e ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje financiare nga Kuvendi i Shqipërisë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE
MINISTRI E SHTETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN
Ermelinda Meksi

SHTOJCA I

KUSHTET

TITULLI I
FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

Neni 1
Parime të përgjithshme

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në

Marrëveshjen financiare[1].

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do të kushtëzohet nga plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje financiare nga ana e Përfituesit.

Neni 2
Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre

2.1 Tejkalimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale të përcaktuar në Marrëveshjen financiare, Komisioni mund ose të zvogëlojë projektin/programin, ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfitusit apo burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se projekti/programi nuk mund të zvogëlohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet ose nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë, në mënyrë të jashtëzakonshme, financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

TITULLI II
ZBATIMI

Neni 3
Kushte të përgjithshme

3.1 Projekti/programi do të zbatohet nga Komisioni, duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e Përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4
Periudha e ekzekutimit

4.1 Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë e shumta në datën 31.12.2009. Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative zbatimi, e cila do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën 31.12.2007. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së ekzekutimit.

Gjatë fazës së mbylljes do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllen teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë e shumta 24 muaj pas kësaj date.

4.2 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financimin e Komunitetin vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.3 Çdo fond i mbetur nga kontributi i komunitetit do të fshihet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit.

4.4 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe,

[1] Shprehja "Marrëveshje financiare" duhet konsideruar e njëjtë me "Letër për përfitimin"

rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

TITULLI III
LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANTEVE

Neni 5
Kushte të përgjithshme

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme në fuqi, në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

Neni 6
Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të nënshkruhen nga të dyja palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, pra deri në datën 16.7.2006. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Norma e mësipërme nuk do të aplikohet për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 6.1 të këtyre kushteve, çdo fond për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë nuk janë nënshkruar, do të fshihet.

6.4 Çdo kontratë për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të fshihen.

Neni 7
Pranueshmëria

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tendera për kontrata për punime, furnizime ose shërbime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në konkurset për propozime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që, në bazën e kushteve specifike të përcaktuara në aktet bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2, të marrin pjesë në tenderat për kontratat.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komuniteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, të furnizimeve dhe të shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit të nisura nga përfituesi i grantit për ekzekutimin e aktivitetit të financuar, duhet të kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për të marrë pjesë, siç përcaktohet në tre paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të aplikohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët do të marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

TITULLI IV
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

Neni 8
E drejta e vendosjes dhe e qëndrimit

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tenderat për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve do të gëzojnë të drejtën e përkohshme të vendosjes dhe të qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës.

8.2 Kontraktorët (duke përfshirë përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të projektit/programit.

Neni 9
Normat tatimore dhe doganore

9.1 Tatimet, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksa ekuivalente) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues duhet të aplikojë për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të aplikuara për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ai ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 10
Normat mbi kursin e këmbimit

10.1 Shteti përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të aplikojë normativën e tij kombëtare për këmbimin e valutës në një mënyrë jodiskriminuese për kontraktorët që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të zbetueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të zbatohen gjithashtu.

Neni 11
Përdorimi i të dhënave nga studimet

Aty ku Marrëveshja financiare përfshin financimin e një studimi, kontrata në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes financiare, duhet të rregullojë pronësinë e këtij studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit ose të Komisionit për të përdorur të dhënat në studim, për ta publikuar atë ose për t'ua dhënë palëve të treta.

Neni 12
Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht, nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara, në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, duhet të alokohen për projektin/programin.

12.2 Ndëshkimet financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati ose pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit, do t'i ripaguhen buxhetit të përgjithshëm të komuniteteve europiane.

TITULLI V
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Transparenca

13.1 Çdo projekt/program i financuar nga Komuniteti do të jetë objekt i operacioneve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme, në fuqi, në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

Neni 14
Parandalimi i parregullsive, mashtrimit dhe korrupsionit

14.1 Përfituesi duhet të marrë masat e përshtatshme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet dhe, me kërkesë të Komisionit, të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 "Parregullsi" do të thotë çdo shkelje e Marrëveshjes financiare, kontratave të zbatimit ose të së drejtës komunitare, e cila shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik, dhe që ka ose do të kishte si efekt cenimin e buxhetit të përgjithshëm të komuniteteve europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura direkt në emër të komuniteteve europiane ose nga çdo zë i pajustifikuar shpenzimi.

"Mashtrim" do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm që lidhet me:

- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve ose deklaratave të rreme, jokorrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i komuniteteve europiane ose nga buxhetet e administruara prej tyre ose në emër të tyre;
- mosdhënien e informacionit në kundërshtim me detyrimet specifike, me të njëjtin efekt;
- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për dhënien e kontratave ose granteve ose në zbatimin e kontratave që lidhen me të.

"Korrupsion pasiv" do të thotë veprim i paramenduar i një nëpunësi, i cili, direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji, çfarëdo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të komuniteteve europiane.

"Korrupsion aktiv" do të thotë veprim i paramenduar i cilitdo që, direkt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, i premton ose i jep një avantazh të çdo lloji, çfarëdo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiara të komuniteteve europiane.

Neni 15
Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra Europiane kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF dhe Gjykata e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni ose në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes financiare (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave dhe granteve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse është e domosdoshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me financimin e projektit/programit gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiare të komuniteteve europiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t'u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF-it dhe të Gykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar, mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes financiare janë kryer, duke përfshirë sistemet e tyre kompjuterike, si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Europian, të OLAF-it dhe Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane do të jepet në kushtet e një konfidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilave ato i nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në një mënyrë që të lejojë inspektim të lehtë të tyre. Përfituesi është i detyruar të njoftojnë Komisionin, OLAF-in ose Gjykatën e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrollet dhe kontrollet financiare të përmendura më sipër do të aplikohen edhe për kontraktorët dhe nënkontraktorët, të cilët kanë përfituar financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni, OLAF-i ose Gjykata e Kontrollit Financiar.

Neni 16
Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit

16.1 Përfituesi dhe Komisioni do të konsultojnë njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje, në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në ndryshimin, ndërprerjen ose përfundimin e Marrëveshjes financiare.

Neni 17
Ndryshimet në Marrëveshjen financiare

17.1 Çdo ndryshim për shtojcën II të Marrëveshjes financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për një ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit duhet t'ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuara nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit ose fazës së mbylljes janë të rregulluara nga neni 4 (5) dhe (6) i këtyre kushteve.

Neni 18
Pezullimi i Marrëveshjes financiare

18.1 Marrëveshja financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes financiare, në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja financiare.

b) Komisioni mund të pezullojë Marrëveshjen financiare, në qoftë se Përfituesi shkel një

detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në rastet serioze të korrupsionit.

c) Marrëveshja financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi, dhe që nuk mund t'i ngarkohet një gabimi ose pakujdesie të tyre (ose kontraktorëve të tyre, përfaqësuesve ose punonjësve), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme, pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen. Difektet në pajisje ose materiale ose vonesat për t'i bërë të disponueshme mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Një palë nuk do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve të saj, në qoftë se nuk ka mundur t'i përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore duhet të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problemit. Gjithashtu, ajo duhet të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 19

Përfundimi i Marrëveshjes financare

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes financiare nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo palë mund të mbarojë Marrëveshjen financiare me dy muaj paralajmërim.

19.2 Kur një marrëveshje financiare nuk ka filluar ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë firmosur sipas datave të përcaktuara në nenin 6.1 të këtyre kushteve, atëherë Marrëveshja financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 20

Rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anën e arbitratit me kërkesën e njërës prej palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga palët do të caktojë një arbitër brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës për arbitrat. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, do të caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditësh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit të caktojë arbitrin e tretë.

20.3 Përveç rastit kur arbitrat vendosin ndryshe, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në rregullat fakultative të arbitrimit për organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e Gjykatës së Përhershme të Arbitratit. Vendimi i arbitrave do të merret me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për aplikimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA II

MASAT TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE

1. Përshkrimi i programit

Forma e programit: CARDS rajonal - Programi vjetor i veprimit 2003

Vendet përfituese: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi (Republika e Serbisë, Kosova*, Republika e Malit të Zi) dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

*nënadministrim ndërkombëtar sipas RKSKB 1244 të datës 10 qershor 1999

Viti buxhetor:	2003
Fondet e çelura:	31 500 000 euro
Zëri buxhetor:	B7-541
Baza ligjore:	Rregullorja e Këshillit për programin CARDS (EC) nr. 2666/2000, ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit (EC) nr.2415/2001, datë 10 dhjetor 2001.
Lidhja e kontratave:	Të gjitha kontratat duhet të lidhen pas firmosjes së Marrëveshjes financiare dhe brenda 36 muajsh duke nisur nga data e çeljes së fondeve buxhetore
Zbatimi:	Zbatimi i projekteve të përfshira në këtë propozim duhet të përfundojë brenda datës 31.12.2007. Për këtë arsye, të gjitha aktivitetet teknike, të parashikuara në këtë program dhe të gjitha kontratat duhet të përfundojnë brenda datës 31.12.2007
Fushat e ndërhyrjes:	Administrimi i integruar i kufijve, forcimi i kapaciteteve institucionale, stabilizimi demokratik dhe zhvillimi i infrastrukturës rajonale
Enti zbatues:	Zyra Europiane e Ndihmës dhe e Bashkëpunimit (Komisioni Europian)
Shënim.	Asnjë shpenzim administrativ nuk do të financohet nga ky program.

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Programi i veprimit rajonal 2003 reflekton Dokumentin Strategjik Rajonal (DSR) të miratuar për vitet 2002-2006 dhe Planin Indikativ Shumëvjeçar (PISH) përkatës për periudhën 2002-2004. Në zbatim të PISH-it, ky program përcakton katër fusha të ndërhyrjes në nivel rajonal, që janë: administrimi i integruar i kufijve, forcimi i kapaciteteve institucionale, stabilizimi demokratik dhe zhvillimi i infrastrukturës rajonale.

Projektet e mbuluara nga Marrëveshja financiare janë si më poshtë:

1. ADMINISTRIMI I INTEGRUAR I KUFIJVE (AIK)

1.1 Strategjitë për AIK-në dhe planet e veprimit

Qëllimi është mbështetja e vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'u siguruar që strategjitë e tyre të administrimit të integruar të kufijve janë të zhvilluara në mënyrë koherente, duke ndjekur një metodologji rajonale të pranuar, për të rritur vetëdijen midis zyrtarëve të zgjedhur në fusha të ndryshme që lidhen me administrimin e integruar të kufijve, në mënyrë që të përmirësohet kuptimi strategjik dhe teknik i standardeve të BE-së dhe i praktikave më të mira në këtë fushë, me qëllimin final zbatimin e strategjive dhe planeve kombëtare të veprimit për administrimin e integruar të kufijve, nëpërmjet zhvillimit të standardeve rajonale dhe zgjidhjeve teknike të përbashkëta. Kjo do të arrihet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- Mbështetje rajonale për t'i paraprirë harmonizimit dhe koordinimit të grupeve të punës interdikasteriale të pesë vendeve në hartimin e strategjive të tyre AIK dhe planeve përkatëse të punës;
- Mbështetja me trajnime rajonale me objektiva të zgjedhura të autoriteve kombëtare përkatëse;
- Takime rajonale të grupeve kombëtare të punës interdikasteriale, duke përfshirë zyrtarët përkatës;
- Realizimi i studimeve dhe vlerësimeve specifike mbi tema të lidhura me AIK-në.

2. FORCIMI INSTITUCIONAL

2.1 Mbështetje e mëtejshme për lehtësimin e mbështetjes së përgjithshme (GSF)

Objektivi i kësaj është të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të administratave publike kombëtare, për të qenë në gjendje të marrin përsipër detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) dhe marrëveshjet që janë pjesë përbërëse të saj, nëpërmjet:

- Studimeve teknike mbi përqasjen, zbatimin, politikat imponuese dhe legjislacionin në fushat kryesore që janë objektiv i programit;
- Misioneve të ekspertëve teknikë;
- Mbledhje pune;
- Vizita studimore dhe vizita të Komisionit. Elemente trajnuese plotësuese mund të shtohen.

- Baza të dhënash, informacioni dhe konsulencë mbi *acquis communautaire*;

- Mbështetje për shërbimet administrative të përkthimit, me qëllim ndërtimin e kapaciteteve të mjaftueshme për përkthimin e *acquis communautaire*;

2.2 Mbështetje për tregtinë

Objektivat janë ato të parashikuara në prioritetet e tregtisë për të gjithë rajonin, që janë:

- Integrimi në OBT- liberalizimi shumëpalësh i Tregtisë, nëpërmjet:

- Asistencës teknike për hartimin e legjislacionit;

- Mbështetjes për vendet e anëtarësuara në OBT në negocimet e Axhendës së Zhvillimit të Dohës (AZHD);

- Zbatimi i marrëveshjeve rajonale dhe/ose dypalëshe të tregtisë së lirë, nëpërmjet:

- Studimeve me qëllim propozimin e strategjive për pakësimin dhe eliminimin e pagesave kryesore jotarifore në rajon;

- Mbështetjes për doganat në administrimin e preferencave të ndryshme tregtare;

- Përmirësimit të bashkëpunimit doganor në zbatimin e rregullave preferenciale të origjinës.

- Përdorimi i plotë i preferencave tregtare autonome, nëpërmjet:

- Seminareve dhe sesioneve të trajnimit mbi standardet veterinare dhe shëndetësore.

- Liberalizim i mëtejshëm i tregtisë, nëpërmjet:

- Studimeve për analizimin e çështjeve që lidhen me realizimin e një zone të vërtetë të tregtisë së lirë në rajon, si alternativë e rrjetit aktual të marrëveshjeve dypalëshe.

- Konkurrencës dhe ndihmës shtetërore (studim për analizimin e gjendjes së legjislacionit dhe strukturave institucionale në rajon; rrjet midis autoriteteve dhe institucioneve homologe në rajon).

- Liberalizimit të shërbimeve tregtare (studime mbi sektorët e shërbimeve me mundësi më të mëdha zhvillimi).

- Mbështetjes për vendet e interesuara në përgatitjen për përafrimin e *"acquis"* komunitar në fushën e tregtisë.

2.3. Sigma - Faza III

Qëllimi është të mbështeten vendet përfituese për realizimin e një kuadri ligjor dhe institucional për të pasur institucione publike të efektshme, të besueshme dhe të përgjegjshme, nën kontrollin efektiv të autoriteteve publike të zgjedhura në mënyrë demokratike, që veprojnë në një shtet të së drejtës dhe në përputhje me ekonominë e tregut. Referencat për këtë projekt do të jenë pikat themelore të zhvilluara në rastin e programit SIGMA për vendet kandidate. Prioritetet janë shërbimi civil dhe reforma administrative, kapacitetet në formulimin e politikave, administrimi i shpenzimeve publike, kontrolli i jashtëm financiar, kontrolli financar, prokurimi publik.

Mbështetja e SIGMA-s do të ofrohet në tri mënyra:

- Punë e vazhdueshme dhe intensive për vlerësimin e përgjithshëm të reformës së administratës publike në rajon;

- Organizimi i më shumë trajnimeve rajonale mbi çështjet kryesore që lidhen me SIGMA-n;

- Mbështetje e vazhduar me objektiva të qartë për administratat e vendeve partnere për realizimin e reformës.

2.4 Program për mbështetjen e institucioneve sociale

Qëllimi është mbështetja e bashkëpunimit në reformën e sektorit social dhe për t'u ofruar modele të reformës vendeve partnere me objektiv forcimin institucional në sektorin social. Projekti do të ofrojë bashkëveprim midis ekspertëve teknikë dhe vendimmarrësve politikë. Kjo duke krijuar një pikë për diskutimin dhe shkëmbimin e informacionit mbi kohezionin social dhe mbrojtjen sociale në të gjitha vendet CARDS, duke i kushtuar vëmendje të veçantë: (i) reformës së pensioneve dhe bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e pensioneve; (ii) mundësisë së përfitimit nga shërbimet sociale për minoritetet; (iii) çështjeve sociale ndërkufitare; (iv) përmirësimit dhe qëndrueshmërisë së skemave të mbrojtjes sociale nëpërmjet një reforme në administrimin e tyre dhe (v) reformës së sistemit të mbledhjes së kontributeve; krijimit të rrjeteve; koordinimit me donatorë të tjerë.

2.5 Forcimi institucional ndërkufitar

Qëllimi është përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve lokale në administrimin e çështjeve lokale, rritja e bashkëpunimit mbi probleme praktike që hasen në rajonet kufitare (probleme

administrative, ligjore, social-ekonomike etj.) dhe rritjen e kohezionit në rajonin CARDS. Kjo do të kryhet nëpërmjet:

- Ofrimit të konsulencës teknike dhe trajnimeve për administratat lokale rajonale;
- Mbështetjes për bashkëpunimin midis shoqatave dhe rrjeteve të autoriteteve lokale dhe rajonale;
- Organizimit të takimeve të bashkëpunimit dhe i sesioneve trajnuese për të përmirësuar kapacitetin e organeve vendore në veprimtarinë ndërkufitare dhe për të nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira;
- Krijimit të lidhjeve midis bashkëpunimit rajonal të BE-së e atij të zonës së vendeve kandidate dhe vendeve CARDS;
- Ofrimit të planeve për aktivitetet dhe konventa bashkëpunimi;
- Fondeve për projekte të vogla në mbështetje të nismave të bashkëpunimit ndërkufitar (me përjashtim të ambientit, i cili mbulohet në kuadrin e programit CARDS rajonal 2002 (Programi i stabilizimit demokratik), me qëllim nxitjen e forcimit të kapaciteteve në nivel lokal.

Për qëllimet e këtij projekti, të gjitha rajonet/ndarjet administrative do të konsiderohen rajone kufitare. Shtetet anëtare të BE-së dhe rajonet e vendeve kandidate do të ftohen të marrin pjesë, në qoftë se pjesëmarrja e tyre do të përfaqësojë një vlerë shtesë për bashkëpunimin.

2.6 Programi "Into Europe"

Ky projekt konsiston në dy komponentë:

Qëllimi i komponentit 1 është rritja e bashkëpunimit midis shërbimeve të integrimit të BE-së dhe ministrive teknike në lidhje me programimin e CARDS dhe çështje të lidhura me procesin e stabilizim-asocimit. Gjithashtu synohet përmirësimi i koordinimit rajonal të ndihmës CARDS dhe një rritje e sensit të përkatësisë së projekteve në kuadrin e programit rajonal CARDS. Këto nëpërmjet:

- Financimit dhe lehtësimit të takimeve të rregullta ndërmjet koordinatorëve kombëtarë të ndihmës dhe ekspertëve teknikë, duke u përqëndruar në temat: integrimi në BE, programimi rajonal i CARDS-it, drejtësia dhe punët e brendshme (krimi i organizuar, migrimi i paligjshëm, trafiqe), tregtia, infrastruktura.

Qëllimi i komponentit 2 është mbështetja dhe forcimi i strukturave institucionale demokratike, veçanërisht i parlamenteve në punën e tyre tematike dhe procedurale, por, gjithashtu, edhe në lidhje me integrimin në BE. Kjo do të realizohet nëpërmjet:

- Trajnimit dhe konsulencës për parlamentarët mbi funksionimin e parlamenteve, integrimin në BE dhe nxitjes së kontakteve ndërkombëtare.

2.7. Forcimi i kapaciteteve për organizatat e biznesit

Qëllimi i projektit është forcimi i kapaciteteve të organizatave të biznesit të Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që ato të luajnë rolin e tyre si zëri i biznesit në procesin e stabilizim-asocimit, në zbatimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe për lehtësimin e zbatimit dhe të kuptimit nga sektori privat të normave dhe rregullave të reja, nëpërmjet:

- Ngritjes së vetëdijes dhe përhapjes së informacionit, lidhur me zhvillimet e fundit të procesit të stabilizim-asocimit;
- Nxitjes së bashkëpunimit ndërrajonal;
- lidhjeve të qëndrueshme ndërmjet organizatave të biznesit të Ballkanit Perëndimor dhe organizatave të BE-së dhe të vendeve kandidate;
- Transferimit të njohurive teknike, ofrimit të mundësive të lidhjes midis organizatave të biznesit të Ballkanit Perëndimor.

2.8. Drejtësia dhe punët e brendshme (DPB) - Bashkëpunimi rajonal në fushën e zhvillimit të sistemeve gjyqësore të pavarura, të besueshme dhe funksionuese, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar 5 000 000 euro (±20%)

Projekti do të kontribuojë për një kuptim më të mirë nga vendet CARDS të standardeve të BE-së dhe të praktikave më të mira në këtë fushë. Qëllimi është ofrimi i një kuadri të detajuar strategjik dhe konceptual për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të besueshëm dhe funksionues, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile, tregtare dhe penale, nëpërmjet:

a) Takimeve tematike rajonale dhe kombëtare, konferencave, tavolinave të rrumbullakëta dhe seminareve me gjykatës, prokurorë dhe personel të imponimit të ligjit për të gjitha çështjet e lartpërmendura (OJF-të dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të përfshihen deri diku, për krijimin e rrjeteve midis aktorëve të interesuar).

b) Misioneve të ekspertëve, sesioneve të analizave gjithpërfshirëse të boshllëqeve dhe nevojave.

c) Aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve: sesioneve të trajnimit, vizitave studimore, asistencës teknike.

d) Krijimit të rrjeteve të informimit, bibliotekave dhe grupeve mbështetëse, me qëllim grumbullimin e informacionit, përmirësimin e bashkëpunimit dhe lehtësimin e veprimit koordinues.

2.9. Bashkëpunimi rajonal në fushën e statistikave

Qëllimi është kontributi në procesin e stabilizim-asocimit, duke zhvilluar më tej transformimin e sistemeve statistikore, në përputhje me nevojat e një shoqërie demokratike dhe të ekonomisë së tregut, si dhe për të siguruar një nivel minimal harmonizimi të metodave statistikore me kërkesat e BE-së, nëpërmjet:

- Përmirësimit të grumbullimit të të dhënave dhe rritjes së bashkëpunimit rajonal midis instituteve kombëtare të statistikave;
- Përafrimit të metodave statistikore dhe konvergjencës graduale drejt përputhjes me legjislacionin e Komunitetit Europian në disa fusha kryesore të statistikave;
- Rritjes së besueshmërisë në statistikat zyrtare dhe përmirësimit të profilit publik të instituteve kombëtare të statistikave;
- Projekteve pilot (testeve mbi metodologjinë dhe grumbullimin e të dhënave);
- Ofrimit të asistencës teknike në këto fusha.

2.10. Plani pilot për pellgun ujëmbledhës në kuadrin e projektit për pellgun ujëmbledhës të lumit Sava

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i administrimit të pellgut ujëmbledhës të lumit Sava dhe, nëpërmjet saj, përmirësimit të cilësisë së ujit dhe pakësimit të ndotjeve dhe përmbytjeve. Qëllimi më i gjerë është krijimi i një mekanizmi bashkëpunimi ndërmjet vendeve ku kalon lumi Sava dhe të pellgut të tij ujëmbledhës. Projekti do të realizojë projekte pilot mbi administrimin e ujërave në çdo vend, në përputhje me direktivën kuadër mbi ujërat të BE-së, në një kontekst transkufitar. Një grup pune rajonal do të ngrihet, i cili do të paraqesë një raport të përbashkët. Kjo do të ralizohet nëpërmjet:

- Një projekti pilot në çdo vend, duke ndjekur udhëzimet e direktivës kuadër mbi ujërat të BE-së;
- Mbështetjes për zhvillimin dhe forcimin e institucioneve të administrimit të ujërave në çdo vend;
- Mbështetjes për strukturat e përbashkëta/transkufitare të administrimit të pellgut ujëmbledhës;
- Bashkëpunimit me nismat e PKBZH/SGA-së[2] dhe me KNMLD-në[3] .

3. STABILIZIMI DEMOKRATIK

3.1. Programi rajonal për mbështetjen e mediave

Sektori i mediave në rajonin CARDS ka ende nevojë të zhvillohet në një sektor ku të zhvillohet media e lirë dhe e pavarur në nivel kombëtar, por gjithashtu për sa i përket bashkëpunimit rajonal, i cili ka nevojë për mbështetje të mëtejshme. Ashtu siç theksohet në DSR, zhvillimi i medias së lirë, të pavarur dhe profesionale është kyç për mbështetjen e stabilitetit dhe të paqes në rajon. Ky projekt përbëhet nga dy komponentë, të përqendruar në produktet rajonale televizive dhe në shkëmbimin e lajmeve rajonale.

Objektivat specifike të komponentit 1 janë rritja e profesionalizimit në produktet televizive dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet tregjeve të produkteve televizive në rajon. Kjo nëpërmjet:

- organizimit të një konkursi për financimin e disa produkteve të përbashkëta televizive rajonale;
- produkteve të përbashkëta për të mbuluar ato fusha ku qytetarët tregojnë një interes të vërtetë dhe që kanë rëndësi për jetën e tyre të përditshme;
- kërkesës për rrjetet kombëtare televizive për transmetimin e këtyre produkteve;
- organizimit të aktiviteteve rajonale të shfaqjes së produkteve.

---

[2] Programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillimin/Struktura Globale për Ambientin (Global Environment Facility)

[3] Komisioni Ndërkombëtar për mbrojtjen e lumit Danub

Propozimet e përbashkëta nga dy apo më shumë organizata nga vende të ndryshme CARDS do të jenë një nga kërkesat.

Komponenti 2 synon të nxisë marrëdhënie të harmonishme dhe paqe nëpërmjet qarkullimit të lirë dhe mundësisë së informacionit, si dhe të nxisë tolerancën, vlerat universale të të drejtave të njeriut, qytetarinë demokratike dhe kulturën e paqes.

E koordinuar nga një sekretariat, i cili ekziston tashmë, ky program:

- do të rrisë raportimin ndërkufitar me anë të grumbullimit të prodhimeve dhe të mbështetjes për udhëtimet;
- do të ofrojë njohuri praktike mbi teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). vetëm në stacionet me aftësi prodhuese analoge dhe do të ndihmojë në vendimet për transformimin e pashmangshëm në platforma dixhitale;
- do të mbështesë transformimin e transmetuesve shtetërorë në transmetues të shërbimit publik, duke rritur konkurrencën e lajmeve televizive me anë të kualifikimit profesional, dhe standardeve e praktikave teknike. Gjithashtu do të diversifikojë kriteret tradicionale të lajmeve;
- do t'u ofrojë pajisje anëtarëve të ERNO-s (Eurovision Regional News Exchange);
- do të ofrojë trajnim për personelin editoral dhe gazetarët, vizita studimore, mbledhje pune të përbashkëta dhe mbledhje dyvjetore për ndjekjen e punës.

3.2 Programi për bashkëpunimin midis rrjeteve të shoqërisë civile

Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i sektorit të shoqërisë civile.

Ky projekt do të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet rrjeteve të organizatave nga BE-ja dhe rajoni për transferimin e njohurive, forcimin e kapaciteteve dhe krijimin e një baze për struktura të qëndrueshme midis organizatave, nëpërmjet:

- zhvillimit të aftësive për krijimin e rrjeteve;
- zhvillimit të aftësive organizative;
- zhvillimit të çështjeve financiare;
- zhvillimit të çështjeve të përkrahjes.

Këto do të ofrohen nëpërmjet partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile (OSHC) nga BE-ja dhe vendet partnere. Partneriteti trekëndor (organizatat e BE-së-2 organizata të vendit partner CARDS) do të inkurajohet në mënyrë të veçantë.

3.3 Mbështetje për kthimin e refugjatëve

Ky program synon të lehtësojë në nivel rajonal pengesat për kthimin e refugjatëve apo shmangien nga ky i fundit. Të gjitha aspektet ligjore, civile, administrative, sociale, psikologjike, kulturore, ekonomike duhet të trajtohen. Refugjatët që vijnë nga dhe për në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi e Mali i Zi do të jenë në veçanti objekti i këtij projekti. Megjithatë, po qe se situata në Ballkanin Jugperëndimor (IRFJ, Shqipëri, Kosovë) përmirësohet dhe krijohen më shumë hapësira për një kthim të sigurt, të njëjtat lloj çështjesh (ndërshtetërore/ndërrajonale për nga Kosova në Serbi) do të trajtohen në të njëjtin projekt. Ky program do të vijojë programin e vitit 2002 në të njëjtën fushë. Projekti i vitit 2002 do të bëjë të mundur qartësimin e pengesave kryesore dhe të nevojave më urgjente në këtë drejtim. Ky projekt do të përqendrohet në aktivitetet të cilat kanë një ndikim direkt në kthimin dhe/ose rikthimin e pronave, në kuadrin e qëndrueshmërisë së paqes për gjeneratat që do të vijnë.

3.4 Programi për zhvillimin e shoqërisë civile lokale

Ky projekt synon të forcojë kapacitetet dhe të mbështesë projektet e organizatave bazë lokale të shoqërisë civile. Objektivat specifikë janë:

- krijimi i një partneriteti midis OSHC-ve që veprojnë në mënyrë lokale/rajonale;
- krijimi i një sektori të qëndrueshëm të shoqërisë civile në nivele lokale;
- forcimi i kapaciteteve për OSHC-të lokale/rajonale;
- projekte për mbështetje konkrete.

Komponenti kryesor do të jetë një konkurs. Organizatat që mund të marrin pjesë do të jenë OSHC rajonale/lokale si partnerë kryesorë. Autoritetet rajonale/lokale mund të marrin pjesë si "junior partners". Partneriteti ndërmjet organizatave nga të paktën dy vende të ndryshme (duke përfshirë vendet anëtare të BE-së dhe vendet kandidate) është një kusht. Mbështetja do të përqendrohet në ato fusha të cilat trajtohen më mirë në mënyrë rajonale/lokale.

Nxitja e projekteve në lidhje me pjesëmarrjen qytetare, mundësia e përfitimit nga shërbimet vendore dhe rajonale nga minoritetet (duke përfshirë refugjatët) etj.

4. INFRASTRUKTURA RAJONALE

4.1. Ambienti: struktura për përgatitjen e projekteve

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të inkurajojë dhe të lehtësojë investimet transkufitare në fushën e ambientit, të lehtësojë kushtet e jetesës dhe të pakësojë ndotjen e ambientit në vendet e Ballkanit Perëndimor (të gjithë sektorët e ambientit mbulohen nga ky projekt), nëpërmjet:

- Mbështetjes për përgatitjen e projekteve për investime të mundshme, në koordinim me institucionet financuese ndërkombëtare (IFN) dhe donatorët dypalësh që veprojnë në rajon.

- Lehtësimit të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve financuese ndërkombëtare dhe CARDS në përcaktimin dhe përgatitjen e projekteve investuese ambientale për financim nga IFN-të.

- Transferimit të njohurive për zhvillimin e projekteve dhe paketave financuese në rajon.

4.2. Rjeti rajonal i transportit - Sekretariati i përhershëm dhe observatori

Objektivi specifik i këtij projekti është ofrimi i mbështetjes teknike për përmirësimin e rrjetit rajonal të transportit. Për këtë rrjet, i njohur si rrjeti strategjik i Komunitetit Europian (apo rrjeti kryesor), është rënë dakord me autoritetet e transportit të vendeve CARDS në takimin e mbajtur në zyrat e Bankës Europiane të Investimeve në Luksemburg, në fillim të shkurtit 2003, në të cilin morën pjesë IFN-të. Mbështetja teknike do të ofrohet duke krijuar një bazë të dhënash për transportin, bazuar në të dhënat e paraqitura nga çdo vend. Për të realizura këtë, praktikat e grumbullimit të të dhënave nga çdo vend do të harmonizohen në një format standard.

Observatori është parashikuar të funksionojë si sekretariat i korridorit transeuropian. Eksperienca ka treguar se korridoret më të mira janë ato që janë të mbështetura më mirë teknikisht. Mësimet e së kaluarës do të merren në konsideratë kur të krijohet observatori i transportit.

Objektivi më i gjerë është lehtësimi afatgjatë i koordinimit rajonal në fushën e transportit, nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm koordinues të përbashkët midis vendeve CARDS dhe të një rrjeti të komunikimit të efektshëm midis tyre, nëpërmjet një rregullimi institucional të përbashkët. Këto mekanizma duhet t'u lejojnë këtyre vendeve të trajtojnë me efektshmëri papërshtatshmëritë dhe pengesat prioritare për rrjetin infrastrukturor të transportit rajonal, si dhe çështjet operative dhe normative të një rëndësie rajonale.

Kjo do të realizohet nëpërmjet:

- Përkufizimit të qartë të problemit për sa i përket objektivave dhe detyrave që duhen realizuar.

- Krijimit të një sekretariati të përhershëm, të vetqëndrueshëm për të gjithë periudhën e mbuluar nga projekti, me seli në rajon dhe me aftësinë për të mbajtur një bazë të dhënash të efektshme.

- Përcaktimit të një axhende të çështjeve, dhe të pengesave e vështirësive aktuale për transportin në rajon, si dhe hartimit të një plani pune.

- Takimeve të shpeshta (në mënyrë të arsyeshme) të zyrtarëve të lartë të qeverive për të trajtuar bashkërisht çështje me rëndësi për transportin rajonal dhe për punën që duhet bërë për zgjidhjen e tyre.

- Komunikimit të efektshëm dhe dialogut me organizatat e tjera, si dhe nismave me përfshirjen e IFN-ve, Komunitetit Europian, Korridoreve etj.

- Zhvillimit të një baze të dhënash mbi trafikun dhe parashikimet, modelimit me anën e kompjutrit; një inventari të detajuar të kushteve fizike aktuale përgjatë akseve të rrjetit kryesor, një inventari të detajuar të vështirësive ekzistuese përgjatë akseve dhe në pika ndërkufitare, një plani pune të rifreskuar vazhdimisht.

- Transferimit të njohurive te sekretariati dhe tek ekspertët kombëtarë nëpërmjet trajnimeve formale (mbledhje pune, seminare), si dhe trajnimit gjatë shërbimit mbi administrimin organizativ dhe mbi çështje teknike substanciale për kërkesat e punës.

2. KOSTOT DHE FINANCIMI

Programi do të financohet nëpërmjet një granti të Komunitetit prej 31 500 000 euro, i ndarë si më poshtë vijon midis aktiviteteve të ndryshme:

Fusha/Projekti	Totali për fushën (euro, milionë)

1. Administrimi i integruar i kufijve	1,00
Strategjitë AIK dhe planet e veprimit	1,00
2. Forcimi institucional	21,80
Mbështetje e mëtejshme për GSF-në	1,25
Mbështetje për tregtinë	1,25
CARDS SIGMA - Faza III	2,00
Program për mbështetjen e institucionit social	2,00
Forcimi institucional ndërkufitar	2,00
Programi "Into Europe"	1,00
Forcimi i kapaciteteve për organizatat e biznesit	2,00
DPB- Sistemet gjyqësore dhe bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar	5,00
Bashkëpunimi rajonal në fushën e statistikave	3,00
Plani pilot për pellgun ujëmbledhës të lumit Sava	2,30
3. Stabilizimi demokratik	5,00
Programi rajonal për mbështetjen e mediave	1,00
Programin për bashkëpunimin midis rrjeteve të shoqërisë civile	1,00
Mbështetje për kthimin e refugjatëve	0.50
Programi për zhvillimin e shoqërisë civile lokale	2,50
4. Infrastruktura rajonale	3,70
Ambienti: struktura për përgatitjen e projekteve	1,80
Observatori për transportin rajonal	1,90
Totali	31,50

Shënim. Totali i buxhetit për çdo sektor/fushë të bashkëpunimit mund të ndryshojë deri $\pm$ 20%.

3. RREGULLAT E ZBATIMIT

Programi i veprimit do të zbatohet si më poshtë vijon:

3.1. Zbatimi dhe administrimi

Marrëveshja financiare përkatëse e këtij propozimi financiar do të lidhet me autoritetet e palës tjetër. Marrëveshja financiare duhet të lidhet brenda 31 dhjetorit të vitit në vijim të vitit të çeljes së fondeve.

Përfundimi i periudhës së zbatimit të Marrëveshjes financiare është përcaktuar këtu më 31.12.2007.

Çdo shumë fondesh e mbetur në dispozicion nën grantin e Komunitetit Europian do të anulohet automatikisht 18 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit të Marrëveshjes financiare.

Kontratat e financuara nga ky program do të hyjnë në fuqi jo më shpejt sesa firmosja e Marrëveshjes financiare në formën e duhur nga firmëtarët kompetentë dhe jo më vonë se 3 vjet duke nisur nga data e çeljes së fondeve, e cila është data e skadimit të marrëveshjeve financiare përkatëse. Për këtë:

- Çdo kontratë ose grant duhet të hyjë në fuqi, pasi të jetë nënshkruar nga të gjitha palët përkatëse, përpara kësaj date skadimi;
- Çdo kontratë ose grant që nuk ka hyrë në fuqi, duke qenë e nënshkruar nga të gjitha palët e interesuara, përpara datës së skadimit, nuk do të finalizohet, por do të anulohet *ex-tunc*;
- Çdo shumë fondesh e këtij programi që nuk përdoret për të financuar kontratat ose grante që janë në fuqi në datën e skadimit do të mbyllet sa më shpejt që të jetë e mundur pas kësaj date;
- Asnjë shtesë që shton fonde prej këtij programi për çfarëdo kontratë ose grant nuk mund të hyjë në fuqi pas kësaj date skadimi.

Data e skadimit përpara së cilës të gjitha aktivitetet kontraktuale të këtij programi duhet të përfundojnë është jo më vonë se një vit kalendarik nga data e skadimit të Marrëveshjes financiare. Për këtë:

- Asnjë shtesë për çfarëdo kontratë ose grant, financuar nga ky program, nuk mund të hyjë në

fuqi pas datës së skadimit të zbatimit[4].

Ky program rajonal do të zbatohet në mënyrë të centralizuar nga Zyra Europiane e Ndihmës dhe e Bashkëpunimit (AIDCO), në emër të dhe në bashkëpunim të ngushtë e konsultim me autoritetet e interesuara, agjencitë ndërkombëtare dhe donatorët, që veprojnë në fushat e ndryshme të programit.

3.2 Tenderimi dhe lidhja e kontratave

Kontratat për shërbime, punime dhe furnizime duhet të lidhen në përputhje me rregullat e tenderimit dhe të lidhjes së kontratave të përcaktuara në rregulloren financiare dhe në udhëzime të tjera.

Për disa nga projektet janë parashikuar lidhje të drejtpërdrejta të kontratave, siç është përcaktuar në pikën 6 të këtij programi.

3.3 Monitorimi, vlerësimi dhe kontrolli financiar

Ky program do të monitorohet dhe do të kontrollohet nga shërbimet e Komisionit Europian, i cili duhet:

a) të kontrollojë zbatimin e programit në bazë të raporteve të rregullta, kontakteve me mbështetësit dhe vizitave në vend;

b) të realizojë monitorimin dhe vlerësime të rregullta për ndjekjen e progresit të programit dhe të komponentëve të tij, si dhe vlerësimet *ex-post* pas kompletimit të programit.

Llogaritë dhe veprimet e kryera nën komponentët e programit mund të kontrollohen me intervale nga një kontrollues financiar i jashtëm i kontraktuar nga Komisioni, pa përjashtuar përgjegjësitë e Komisionit Europian, duke përfshirë Zyrën Europiane Antimashtrim (OLAF) dhe Gjykatën e Kontrollit Financiar të Bashkimit Europian.

4. ANGAZHIMET E QEVERISË/KUSHTËZIMIT

Ndihma ofrohet mbi bazën e ekzistencës së elementeve të nevojshme për vazhdimin e bashkëpunimit nëpërmjet ndihmës, në veçanti respektimi i principeve demokratike dhe i të drejtave të njeriut, si dhe detyrimet e vendit përfitues, të përcaktuara në Marrëveshjen e Partneritetit dhe Bashkëpunimit-marrëveshjen/procesin e stabilizim-asocimit. Gjithashtu, përveç kushtëzimeve që rrjedhin nga procesi i stabilizim-asocimit, kushtëzimet programore/sektoriale/të projekteve mund të imponohen. Mospërmbushja e çdo kushti të përcaktuar mund të sjellë vonesën, pezullimin ose fshirjen e ndihmës së planifikuar dhe të angazhuar.

VENDIM
Nr.851, datë 19.12.2003

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, QË PREKET NGA NDËRTIMI I DEPOS SË UJIT TË UJËSJELLËSIT TË POLOSKËS NË QENDËR, DEVOLL TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i depos së ujit të ujësjellësit të Poloskës, Qendër, Devoll.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Qendër, Devoll.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që i bashkëngjitet këtij vendimi, për sipërfaqen 400 m^2 tokë/are, e vlerësuar në

[4] Data e përfundimit të aktiviteteve kontraktuale i referohet aktiviteteve të zbatimit të projekteve dhe jo datës së dërgimit të raportit përfundimtar apo të faturës përfundimtare.

shumën e përgjithshme prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Investime", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 126 600 (njëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, miratuar për komunën Qendër, Devoll.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.12.2003.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, prefektura e qarkut të Korçës dhe komuna Qendër Devoll për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lista emërore e pronarit që do të shpronësohet për ndërtimin e depos së ujit të ujësjellësit të Poloskës, Devoll

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sip/tokës m^2	Njësia lekë m^2	Vlera lekë
1.	Haxhi Hysen Gjoza	400	1000	400.000
	Shuma	400		400.000

VENDIM
Nr.853 , datë 19.12.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.309, DATË 15.5.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË ALBKROM SHA, QË SHKURTOHEN NGA PRIVATIZIMI DHE DHËNIA ME KONCESION E INDUSTRISË SË KROMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albkrom" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.309, datë 15.5.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

a) Fjalët "…të cilët shkurtohen gjatë vitit 2003…" zëvendësohen me "… të cilët shkurtohen deri në fund të vitit 2004…"

b) Në fund, pas fjalës "…Albkrom, sh.a-së, shtohet shprehja "…dhe të ardhurat e tjera, që sigurohen nga veprimtaria e shoqërisë, gjatë likuidimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.854, datë 19.12.2003

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË AKREDITIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 14 të ligjit nr.9024, datë 6.3.2003 "Për akreditimin e laboratorëve testues, kalibrues, organizmave certifikuese dhe inspektuese në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Drejtorisë së Akreditimit, si institucion me financim nga Buxheti i Shtetit, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, e cila administron tërë sistemin e akreditimit në Republikën e Shqipërisë, si një institucion i pavarur dhe i paanshëm.

2. Drejtoria e Akreditimit të akreditojë subjektet e interesuara, private dhe publike, që kryejnë testim, kalibrim, inspektim, certifikim të produkteve, të sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe të mjedisit, të personelit, si dhe subjektet që kryejnë veprimtari të njëjta, të përcaktuara me akte ligjore. Ky institucion ua ofron këtë shërbim edhe subjekteve të huaja, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

3. Drejtoria e Akreditimit harton rregulloren e vet të brendshme, që miratohet nga Ministri i Ekonomisë. Drejtori i Përgjithshëm raporton, periodikisht, te ministri, për ecurinë e punës.

Marrëdhëniet ndërmjet tyre rregullohen në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Ekonomisë.

4. Subjektet e interesuara për këtë shërbim duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Akreditimit me një kërkesë për akreditim, e cila bën vlerësimin e kësaj kërkese në bazë të standardeve dhe të udhëzuesve të nxjerra nga organizmat ndërkombëtarë të akreditimit. Për kryerjen e vlerësimit të kërkesës Drejtoria e Akreditimit ngarkon specialistë, të cilët veprojnë në emër të këtij institucioni. Drejtoria e Akreditimit duhet t'i komunikojë kërkuesit vendimin e vlerësimit dhe t'i japë atij mundësinë për ta kundërshtuar atë. Vendimi i komunikohet edhe bordit të akreditimit. Drejtoria e Akreditimit i jep palës së interesuar të gjitha të dhënat e nevojshme për vlerësimin e kërkesës për akreditim.

5. Për të ndihmuar dhe mbështetur mbarëvajtjen e procedurave të akreditimit krijohet bordi këshillimor i akreditimit, i cili funksionon pranë Drejtorisë së Akreditimit. Bordi mbështet Drejtorinë e Akreditimit dhe autoritetet e tjera publike për çështjen e akreditimit. Anëtarët e bordit emërohen nga Ministri i Ekonomisë, për një periudhë 3-vjeçare dhe jo më shumë se dy herë radhazi. Numri i anëtarëve të bordit është 11 veta. Anëtarët janë përfaqësues të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Universitetit Politeknik, Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit.

Drejtoria e Akreditimit ka përgjegjësi për organizimin e punës dhe për realizimin e detyrave të bordit të akreditimit.

Rregullimi i veprimtarisë së bordit bëhet me rregullore të brendshme, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë. Bordi këshillimor mblidhet jo më shumë se një herë në muaj. Anëtarët e bordit shpërblehen me 3 000 (tre mijë) lekë për çdo mbledhje.

6. Në rastet e veçanta, për ndjekjen e procedurave të akreditimit, kur nga Drejtoria e Akreditimit vlerësohet e nevojshme, krijohen komitete teknike, të përbëra nga specialistë të fushave të caktuara, të cilët hartojnë kërkesat e veçanta për akreditim në fushat përkatëse. Ata emërohen nga Ministri i Ekonomisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Akreditimit. Shpërblimi i tyre përcaktohet nga Ministri i Financave.

7. Akreditimi është i vlefshëm për katër vjet. Drejtoria e Akreditimit i lëshon kërkuesit certifikatën e akreditimit, e cila përmban emrin dhe adresën e organizmit të akredituar, fushën e akreditimit, standardin ose udhëzuesin e përdorur për vlerësim dhe vlefshmërinë e akreditimit. Riakreditimi mund të sigurohet pas një rivlerësimi të plotë. Subjektet e akredituara kanë të drejtë të përdorin stemën e akreditimit, në përputhje me procedurat e veçanta të Drejtorisë së Akreditimit.

8. Drejtoria e Akreditimit, gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit, mbikëqyr statusin e akreditimit. Për organizmat e vlerësimit të konformitetit, mbikëqyrja e akreditimit organizohet nga Drejtoria e Akreditimit, kur organet përkatëse kryejnë kontrollet periodike të vlerësimit të statusit të autorizimit. Subjekti i akredituar duhet të sigurojë vazhdimësinë e plotësimit të kushteve të

akreditimit. Ai duhet të njoftojë, brenda 1 muaji, Drejtorinë e Akreditimit për çdo ndryshim të rëndësishëm, i cili mund të cenojë plotësimin e kushteve të akreditimit.

9. Drejtoria e Akreditimit, kur kushtet e akreditimit nuk plotësohen, ka të drejtë ta pezullojë ose ta tërheqë akreditimin. Në rastet e moskonformiteteve në shkallë të ulët, ku si të tilla vlerësohen ato që nuk cenojnë vlefshmërinë e akreditimit, Drejtoria e Akreditimit mund t'i ngarkojë detyra shtesë organizmit deri në plotësimin e kushteve .

10. Në rast pezullimi të autorizimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit Drejtoria e Akreditimit njoftohet nga organet përkatëse për të kryer vlerësimin e kushteve të akreditimit.

11. Drejtoria e Akreditimit u jep të dhëna subjekteve të interesuara, publike ose private:

- për parimet, kushtet, procedurat dhe tarifat e akreditimit;
- për subjektet e akredituara në Republikën e Shqipërisë;
- për adresat e organizmave të huaja të akreditimit.

12. Drejtoria e Akreditimit, për kryerjen e detyrave të parashikuara në ligj, bashkëpunon me institucionet publike dhe subjektet private, vendase ose të huaja, si dhe merr pjesë në veprimtarinë e saj.

13. Kreu III i vendimit nr. 371, datë 4.8.1999 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit, certifikimit dhe akreditimit", shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.855, datë 19.12.2003

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 588, DATË 22.12.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROCEDURËN ZYRTARE TË CAKTIMIT TË DELEGACIONIT SHQIPTAR NË KONGRESIN EUROPIAN TË AUTORITETEVE LOKALE DHE RAJONALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.588, datë 22.12.1997 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Delegacioni shqiptar në Kongresin e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Europës përbëhet nga katër anëtarë dhe katër zëvendësues, përkatësisht të ndarë në:

- dy anëtarë dhe dy zëvendësues (përfaqësues nga organet e zgjedhura vendore të bashkive dhe komunave), që marrin pjesë në Dhomën e Autoriteteve Vendore të Kongresit;
- dy anëtarë dhe dy zëvendësues (përfaqësues nga organet e zgjedhura të qarqeve), që marrin pjesë në Dhomën e Autoriteteve Rajonale të Kongresit.".

2. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Përbërja e delegacionit shqiptar në Kongresin e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Europës përcaktohet nga shoqatat vendore të të zgjedhurve, sipas një procedure të përcaktuar nga ata vetë, në raport me vendet e përfaqësimit në dy dhomat, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi. Anëtarët e delegacionit duheT të kenë mandatin e të zgjedhurit vendor në zgjedhjet e fundit, të zhvilluara në komunën, bashkinë apo qarkun përkatës.".

3. Në pikën 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“ Procedurat dhe kriteret për përcaktimin e zëvendësuesve në delegacion janë të njëjta me ato të përcaktimit të anëtarëve.”.

4. Në pikat 4 e 5, emërtimet ”Sekretariati i Kongresit Europian të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale” dhe “Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës” zëvendësohen me “Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës”.

5. Në të gjithë vendimin fjala “Lokale” zëvendësohet me “Vendore” dhe emërtimi “Sekretariati i Shtetit për Pushtetin Lokal” zëvendësohet me “Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 856 , datë 4.12.2003

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HAPJEN E MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË SELISË SË NATO-S"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2 të vendimit nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave shtohet paragrafi, si më poshtë vijon:

"Në këtë mision funksionon përfaqësia ushtarake.

Kjo përfaqësi përbëhet nga:

- Përfaqësuesi ushtarak i misionit në Nato	oficer	gjeneral-brigade;
- Zëvendëspërfaqësuesi ushtarak i misionit në Nato	oficer	kolonel;
- Oficer shtabioficer	nënkolonel;	
Specialist/ Koordinues	oficer	major;
- Nënoficer i administrimit/sekretar	nënoficer	k/kapter.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.22, datë 30.12.2003

PËR ÇMIMET DHE TARIFAT E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2004

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26 pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga KESH sh.a., si dhe materialin përkatës,

VENDOSI:

1. Çmimet dhe tarifat e shitjes së energjisë elektrike për vitin 2004 të jenë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

BORDI I KOMISIONERËVE TË ERE-S

ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË APROVUARA NGA ERE PËR VITIN 2004

	Kategoritë e konsumatorëve	Çmimi lekë/kWh
TL	Buxhetore	8.3
	Jobuxhetore- ujësjellës	5.5
	Jobuxhetore- të tjerë	8.3
	Private	8.3
	Media	7
TM	Buxhetore	9
	Jobuxhetore-ujësjellësi	5.6
	Jobuxhetore (nafta, kromi, çimento, plehra kimike)	8.4
	Jobuxhetore- furnizuar në TM, matur në TM	10.5
	Jobuxhetore- furnizuar në TM, matur në TL	11
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhim mielli, stacione pompimi	5.7
	Privatë të favorizuar-objekte kulti	5.8
	Privatë- furnizuar në TM, matur në TM	10.4
	Privatë-furnizuar në TM, matur në TU	10.5
	Media	7
TU	Buxhetore	9.5
	Jobuxhetore-ujësjellësi	6.5
	Jobuxhetore (nafta, kromi, bakër, çimento, plehra kimike)	8.5
	Jobuxhetore- furnizuar në TU	12
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhime mielli, stacione pompimi	6
	Privatë të favorizuar-objekte kulti	6
	Privatë-furnizuar në TU	12
	Familjarë nën 220 kWh	4.5
	Familjarë mbi 220 kWh	8.9
	Media	7.5

Shënim. Energjia e përdorur për ambientet e përbashkëta (Ndriçim shkalle, ashensor, pompë uji) do të faturohen me çmimin prej 4,5 lekë/kWh.

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.105/2003, në ligjin nr.9161, datë 18.12.2003 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, në faqen 4530:

Është	Bëhet:
Pasqyra nr.3	Hiqet pasqyra nr.3

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 16.1.2004

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë